



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 22.18.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË
GJILANIT PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e Ekipit - Erëmira Bytyqi-Pllana, si dhe Anëtarët Hysen Boqolli dhe Mexhit Ferati, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Mujë Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	22
5 Qeverisja e mirë.....	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	27
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	30
Shtojca III: Letër Konfirmimi.....	38

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 09/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Komunës së Gjilanit.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Komunës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj se obligimet e papaguara të shpalosura në pasqyrat financiare vjetore nuk ishin plotësisht të sakta, përkatësisht të nënvleresuara për 5,899,297€.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2017

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Komunës së Gjilanit. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Gjilanit se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Gjilanit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim, vëmendjen tuaj se obligimet e papaguara të shpalosura në PFV nuk ishin plotësisht të sakta, përkatësisht të nënvlerësuara për 5,899,297€. Në vijim kemi prezantuar detajet, si:

- Obligimet e papaguara ishin nënvlerësuar për 6,129,663€, si pasojë e mos prezantimit të obligimeve për shpronësime të krijuara në vitin 2017. Mos prezantimi i tyre ishte si rrjedhojë e mungesës së komunikimit të rregullt në mes të drejtorive, përkatësisht neglizhenca e Drejtorisë së Kadastrit për të dërguar vendimet mbi shpronësimet te Drejtoria e Financave; dhe
- Në anën tjetër, obligimet e paraqitura në PFV ishin mbivlerësuar për 230,366€, si pasojë e regjistrimeve të dyfishta të faturave dhe mos-shlyerjes se obligimeve të paguara.

Opinionin jonë nuk është kualifikuar për këtë çështje.

Çështjet kyçe të auditimit

Deri në fund të vitit 2017, Komuna e Gjilanit ka njohur detyrime kontingjente në vlerë 8,067,039€. Nga kjo, të vlerësuara në shkallën e dytë, me mundësi më të përafërt të ndodhjes janë 2,290,141€, ndërsa shpenzimet procedurale vlerësohen prej 30,392€. Paditë ndaj komunës kryesisht kishin të bënin me kompensime për eksproprijim (shpronësime), kompensim të borxhit dhe të të ardhurave personale.

Marrë parasysh vlerën e lartë të obligimeve të papaguara, materializimi i mundshëm i detyrimeve kontingjente do të shpiente në pasoja të rënda financiare për komunën. Shpenzimet e Komunës nga proceset gjyqësore gjatë vitit 2017 ishin 122,530€. Nga kjo vlerë, 5,363€ kishin rezultuar shpenzime procedurale nga proceset gjyqësore.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryetari i Komunës së Gjilanit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Kërkesat e Ligjeve Organike për Qeverisje Lokale;
- Kërkesat e Ligjit të Buxhetit të vitit 2017;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve.

Në kontekst të PFV-ve, këshilla e dhënë në Memorandumit e Auditimit lidhur me mosprezantimin e saktë të pasurisë, është adresuar, me ç'rast pasuritë janë regjistruar në regjistrin kontabël dhe vlera e tyre është shpalosur në PFV.

Në PFV e dorëzuara në muajin janar 2018, tek neni 14, Raporti i ekzekutimit të buxhetit, ishin prezantuar gabimisht të hyrat nga gjobat e trafikut, gjykatës dhe nga ekonomia e pyjeve në vlerë totale 402,782€. Me pas komuna ka korigjuar pasqyrat e saj duke përmirësuar raportimin e të hyrave vetjake. Megjithëse edhe pas korigjimit shpalosjet e obligimeve nuk ishin të sakta (ref. Theksimi i çështjes në opinionin e auditimit).

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjen e sipërpërmendur jepen rekomandimet, si:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për të eliminuar gabimet në shpalosjen e obligimeve të papaguara dhe për ta konfirmuar vlerësimin e saktë të tyre.

Gjithashtu, Kryetari duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Komuna e Gjilanit kishte shpenzuar 91% të buxhetit final për vitin 2017. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar ekzekutimin e pagesave në mënyrë jo të rregullt.

Si pasojë e moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e prokurimit vazhdon të mbetet sfiduese, duke rezultuar me vonesa në realizim të projekteve dhe mosarritje të vlerës më të mirë për paratë të shpenzuar. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme janë menaxhimi i projekteve kapitale, menaxhimi i faturave të papaguara, kontrollet mbi ndarjen e subvencioneve si dhe menaxhimi i pasurisë.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	22,657,745	24,090,825	21,945,524	21,796,138	21,768,593
Granti i Qeverisë -Buxheti	17,770,855	17,596,998	17,522,089	17,591,784	18,131,828
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	1,285,442	1,203,985	991,063	808,055
Të hyrat vetjake ³	4,599,390	4,599,390	3,078,570	2,955,200	2,656,679
Donacionet e brendshme	-	3,193	3,152	116,061	40,680
Donacionet e jashtme	-	318,302	137,728	142,030	131,351
Financimet nga huamarrja	287,500	287,500	-	-	-

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,433,080€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak, në total prej 1,285,441€, donacioneve të brendshme dhe të jashtme në vlerë 321,495€, ndërsa më pas vlera prej 173,857€ nga kategoria e pagave është shkurtuar si pasojë e Vendimit të Qeverisë.

Në vitin 2017, Komuna ka shpenzuar 91% të buxhetit final ose 21,945,524€. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	22,657,745	24,090,825	21,945,524	21,796,137	21,768,593
Pagat dhe Mëditjet	14,710,814	14,625,244	14,394,998	14,543,245	14,265,786
Mallrat dhe Shërbimet	2,629,598	3,029,681	2,653,764	2,602,945	3,011,107
Shërbimet komunale	562,200	594,141	496,834	547,743	595,739
Subvencionet dhe Transferet	554,086	712,397	536,720	732,119	625,446
Investimet Kapitale	4,201,047	5,129,362	3,863,208	3,370,086	3,270,515

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Në raport me buxhetit fillestar, buxheti final për shpenzime kapitale kishte pësuar rritje për vlerën 928,315€. Kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave vetjake për vlerën 738,595€ dhe pjesa tjetër prej 189,720€ nga grantet e donatorëve. Shpenzimet e realizuara për investime kapitale në raport me buxhetin final janë 75%.
- Buxheti për paga dhe mëditje në buxhetin final ishte zvogëluar për 85,570€. Fillimisht me vendim të Qeverisë buxheti është zvogëluar në vlerë prej 173,858€. Ky zvogëlim ka ardhur si rezultat i një numri të punonjësve të suspenduar nga komuna. Më pas, rritja nga të hyrat vetjake dhe nga grantet e donatorëve ishte në vlerë 88,288€.
- Buxheti final i mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 400,083€. Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime përfshinë gjithashtu të hyrat e bartura nga viti i mëparshëm prej 365,340€ si dhe nga donatorët e jashtëm prej 34,740€. Sidoqoftë, realizimi ishte 88% dhe pavarësisht kësaj, niveli i detyrimeve të papaguara nga kjo kategori ishte 794,837€;
- Buxheti për komunalitet ishte rritur për 31,941€. Kjo shumë ishte rritur si rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak. Niveli i realizimit ishte 84%; si dhe
- Subvencionet dhe transferet në buxhetin final ishin rritur për vlerën 158,311€. Kjo rritje ishte nga grantet e donatorëve në vlerën 88,700€ dhe nga të hyrat e bartura vlera 69,610€. Realizimi në këtë kategori ishte 75%.

Çështja 2 - Keq-klasifikimi i shpenzimeve

- E gjetura** Pagesat e testuara në vlerë totale prej 181,516€, ishin paguar nga investimet kapitale ndonëse sipas natyrës këto shpenzime i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Këto pagesa kishin të bëjnë me mirëmbajtjen e ndriçimit publik si dhe sinjalizimin horizontal dhe vertikal dhe mirëmbajtjen e semaforëve. Kjo kishte ndodhur pasi si projekte ishin planifikuar në PIP, si pasojë e planifikimit dhe buxhetimit jo të drejtë.
- Rreziku** Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve shpie në paraqitje jo të drejtë të shpenzimit në pasqyra financiare, në këtë rast duke mbivlerësuar shpenzimin e kategorisë së investimeve kapitale kundrejt nën shpenzimit të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.
- Rekomandimi 2** Kryetari, të sigurojë se planifikimi dhe buxhetimi i shpenzimeve bëhet konform natyrës së shpenzimeve, në mënyrë që klasifikimi i shpenzimeve bëhet sipas kategorive adekuate.

3.2 Të hyrat

Gjatë vitit 2017, komuna ka inkasuar të hyra në vlerë 3,672,615€, apo 80% të buxhetit të planifikuar (4,599,390€). Kategoritë nga ku janë realizuar të hyrat janë: tatimi në pronë në vlerë 1,437,765€, taksa për leje ndërtimi në vlerë 1,141,164€ dhe të tjera në vlerë 1,093,686€. Nga shpenzimet e përgjithshme që në total ishin prej 21,945,524€, vlera prej 4,282,554€ ishte mbuluar nga të hyrat vetjake apo shprehur në përqindje, 19%. Pjesa e pashpenzuar prej 1,602,276€ do të vijonin si të hyra të bartura në vitin vijues.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	4,599,390	4,599,390	3,672,615 ⁴	3,763,189	3,627,760
Totali	4,599,390	4,599,390	3,672,615	3,763,189	3,627,760

Në raport me vitin 2016, inkasimi i të hyrave ka pësuar një rënie prej 2% apo në vlerë 90,574€. Kjo rënie vjen si rezultat i mosaplikimit të ligjit të faljeve të borxheve në vitin 2017, rezultat i të cilit në vitin 2016 qytetarët kanë paguar në masë më të madhe.

⁴ Në këtë shume nuk janë përfshirë të hyrat indirekte (gjobat e trafikut, gjykatave dhe te agjencionit pyjor) në shumë prej 402,782€.

Çështja 3 - Mosverifikimi i shënimeve ekzistuese lidhur me pronat e tatueshme

- E gjetura** Bazuar në UA 03/2011, neni 13, zyra komunale e tatimit në pronë është e obliguar të bëjë verifikimin e 1/3 të pronave të regjistruara. Nga 32,833 prona, komuna kishte verifikuar vetëm 4,587 objekte, ose 14% të pronave. Sipas zyrtareve të komunës, mos arritja e verifikimit të 1/3 të pronave, ishte për shkak të numrit të pamjaftueshëm të punonjësve të angazhuar në këtë aktivitet.
- Rreziku** Mos verifikimi i pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale dhe si rezultat nënvlerësimin e arkëtimeve nga kjo kategori.
- Rekomandimi 3** Kryetari duhet të siguroj që të merren masa të nevojshme në mënyrë që të bëhet verifikimi i 1/3 të pronave për tatimin në pronë, në mënyrë që shënimet rreth tatimit në pronë të jenë të plota dhe të maksimizohen përfitimet nga kjo e hyrë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë më: kontrollin e pagesave, duke i nënshkruar listat e pagave; verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqesin në mes të formularëve; rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin më thesar. Buxheti final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 14,625,244€, ndërsa shpenzimet ishin prej 14,394,998€ apo 98%.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2017 ishte 3,623,821€. Prej tyre ishin shpenzuar 3,150,598€ apo 87% e buxhetit. Pjesa më e madhe e tyre kanë të bëjnë me: shpenzime komunale, derivate dhe lëndë për ngrohje, shërbime kontraktuese, si dhe mirëmbajtje dhe riparime.

Çështja 4 – Mospërputhje e vlerës së kontratës me çmimin e korrigjuar në ofertë

- E gjetura** Në dosjen e tenderit “Furnizim me material administrativ për zyre” komisioni për vlerësimin e ofertave, ka bërë korrigjimin e vlerës së ofertës për gabime aritmetikore nga 46,768€ në 47,328€, mirëpo vlerësimi i tyre nuk është marrë për bazë gjatë nënshkrimit të kontratës. Kontrata është nënshkruar me vlerën e ofertës së dorëzuar.
- Rreziku** Lëshime të tilla si rezultat i mungesës së shqyrtimit të duhur të dokumentacionit para nënshkrimit të kontratës, mund të rezultojë me dëmtime të njëjës palë në aspekt financiar, në këtë rast të operatorit ekonomik.
- Rekomandimi 4** Kryetari, të siguroj se aplikohen kontrole të duhura në procesin deri të nënshkrimit të kontratës, me ç’rast vërtetohet se të dhënat në përmbajtjen e kontratës janë të sakta.

3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 712,397€. Prej tyre në vitin 2017 ishin shpenzuar 536,720€ apo 75% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e fermerëve, teatrit, ndihmë shëndetësore si dhe bursa për arsim.

Çështja 5 – Ndarja e subvencioneve në mos pajtueshmëri me rregulloren komunale

- E gjetura** Bazuar në rregulloren komunale mbi ndarjen e subvencioneve, është formuar komisioni vlerësues, për t’i vlerësuar kërkesat për subvencione, sipas kriterëve të përcaktuara. Në projektin për subvencionimin e fermerëve “Fare gruri” në vlerë 22,893€, në disa dosje të aplikuesve, kemi vërejtur se një ndër kriteret e kërkuara siç ishte fleta poseduese e tokës, nuk ishte plotësuar, pasi që aplikuesit nuk kishin dëshmuar se tokat ishin në emër të tyre, ndonëse ishin përzgjedhur si të përgjegjshëm dhe ishin përfitues të subvencioneve.
- Gjithashtu, komuna kishte subvencionuar manifestimin “Muaji i mërgimtarëve” në vlerë 4,000€, me vendim të Kryetarit të Komunës. Komuna nuk kishte lidhur një marrëveshje mirëkuptimi me OJQ-në e subvencionuar, ashtu siç parashihet në rregullore. Mungonte po ashtu raporti narrativ për zhvillimin e aktiviteteve.

Ndërsa, për subvencionin e ndarë ndaj teatrit në vlerë 12,420€, për shfaqjen Talia, teatri nuk kishte ofruar raportin narrativ lidhur me subvencionin e shpenzuar.

Rreziku Mangësitë e identifikuar në vlerësimin e kritereve dhe monitorimin e subvencioneve, mund të rezultojnë me devijime nga qëllimet e përfitimit të tyre dhe vlerë të ulët për paranë e paguar. Për më tepër, mungesa e raportimeve zbeh përgjegjshmërinë e përfituesve dhe të stafit të komunës gjatë trajtimit të lëndëve si dhe redukton mundësinë e menaxhmentit për ndërmarrjen e veprimeve efektive dhe në kohë.

Rekomandimi 5 Kryetari të siguroj se ndarja e subvencioneve bëhet në bazë të kritereve të përcaktuara në rregullore, përfshirë monitorimin e duhur të shpenzimit të tyre, në mënyrë që subvencionet e dhëna të arrijnë qëllimin e synuar.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,129,362€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 3,863,208€ apo 75% e buxhetit. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin dhe mirëmbajtjen investive të rrugëve, ndërtesave afariste, objekteve shëndetësore, memoriale si dhe shpronësimet e tokave.

Çështja 6 - Shpronësimet në mos pajtueshmëri me kornizën ligjore

E gjetura Sipas Ligjit nr.03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme, njoftimet/vendimet preliminare si dhe përfundimtare lidhur me shpronësimin e pronave të paluajtshme, duhet të publikohen në Gazetën Zyrtare dhe në një gazetë me tirazh të madh në vend. Nga pagesat e testuara në vlerë 204,702€ lidhur me shpronësimet me qëllim të ndërtimit të çerdhes dhe shkollës fillore, si dhe projektit mbi hapjen e rrugës publike, vendimet preliminare dhe ato përfundimtare nuk ishin publikuar. Vlera totale e shpronësimeve për këto projekte sipas vendimeve ishte 619,148€. Derisa ishim në auditim, ne nuk kemi marrë një përgjigje konkrete lidhur me arsyen e mospublikimit të tyre.

Rreziku Mospublikimi i njoftimeve/vendimeve lidhur me shpronësimet, rrezikon transparencën dhe ligjshmërinë e shpronësimeve/pagesave të bëra.

Rekomandimi 6 Kryetari, të siguroj se janë marrë masa për publikimin e të gjitha vendimeve lidhur me shpronësimet e bëra dhe më tutje për çdo proces të tillë në të ardhmen, të publikohen vendimet sipas kërkesave ligjore.

Çështja 7 - Mungesë e projektit ekzekutiv dhe vendndodhjes së punëve të kryera

E gjetura Sipas ligjit të prokurimit, neni 28, specifikat teknike për kontrata pune, duhet të përfshijnë si pjesë substanciale të veten një projekt ekzekutiv. Në tenderin “Investime të vogla në infrastrukturë”, sipas së cilit ishte lidhur kontrata publike kornizë tri-vjeçare, në vlerë 190,333€, dokumentacioni i tenderit ishte lëshuar pa bashkangjitur projektet e përcaktuara për investime, por vetëm me paramasat dhe parallogaritë paushalle të përgatitura nga njësia kërkuese. Kjo kishte ardhur si rezultat i mos identifikimit të lokacioneve të nevojshme për investime në infrastrukturë.

Tek kontrata “Mirëmbajtja verore e rrugëve”, ndonëse ishte bërë pagesa situacionit përfundimtar në vlerë 358,034€, nuk ishte bërë pranimi teknik nga komisioni i pranimit të punëve.

Rreziku Duke pasur parasysh se autoriteti kontraktues në mënyrë mandatore duhet të bashkëngjisë projektin ekzekutiv specifikave të dosjes së tenderit, mungesa e një projekti të tillë përbën kundërshtim të plotë me ligjin dhe si i tillë rrezikon që objektivat e komunës të mos arrihen në nivelin e dëshiruar.

Rekomandimi 7 Kryetari, të rishikoj arsyet e dështimit të kontrolleve në përgatitjen e tenderimeve për kontrata ndërtimi dhe të siguroj se projektet e synuara janë qartë të definuara. Më tutje, me rastin e pranimit të situacioneve për pagesë, të siguroj se i gjithë dokumentacioni është i kompletuar, përfshirë edhe dëshmitë mbi lokacionet e vend punimeve.

Çështja 8 - Vonesat në ekzekutimin e kontratave

E gjetura Tek kontrata për “Rregullimin e shtratit të lumit Mirusha faza 2” në vlerë 3,133,170€ nënshkruar në vitin 2012, ditët e kontraktuara të punimeve ishin 196, ndërsa të ekzekutuara ishin 705 ditë pune, ndërkohë që punimet ende nuk kishin përfunduar. Sipas raportit të mbikëqyrësit të kontratës, shkak i vonesave ndër të tjera ishin edhe mos angazhimi i mjaftueshëm i fuqisë punëtore nga ana e punëkryesit, si dhe mungesa e kapaciteteve të makinerisë.

Vonesa janë hasur edhe në kontratat si: Rregullimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik në rrugën e Gjinollëve në vlerë 79,779€, Rregullimi i kanalizimit në Perlepnice në vlerë 89,784€, Ndërtimi i çerdhes, në lagjen Dardania 1 në vlerë 374,555€, Rregullimi i kanalizimit në fshatin Bresalc në vlerë 215,835€, ku në secilën prej tyre ishte tejkalar dukshëm plani dinamik, ndërsa në një rast kishte skaduar siguria e ekzekutimit dhe e njëjta nuk ishte ripërtërirë, ndonëse punimet kishin zgjatur më tej. Megjithatë autoriteti kontraktues nuk kishte ndërmarrë ndonjë masë sipas kushteve në kontratë.

Vlen të theksohet, se për kontratat e potencuara më lartë, punimet ishin realizuar duke mos përfillur kërkesat e ligjit të ndërtimit, për pajisje me leje ndërtimore, leje të përdorimit si dhe mbikqyrje inspektive.

Rreziku Moskompletimi i dokumentacionit sipas kërkesave ligjore mund të jetë shkak për vonesat në realizimin e projekteve, e të cilat më pas kanë efekt negativ mbi shpenzimin e buxhetit, duke ndikuar në bartjen e obligimeve nga viti në vit, si dhe mos shfrytëzimin e përfitimeve të parapara të qytetarëve nga shërbimet që ato ofrojnë.

Rekomandimi 8 Kryetari, të sigurojë se çdo projekt të jetë i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kërkesat ndërtimore, më tutje të sigurojë se forcohen kontrollet në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve në mënyrë që ato të përfundohen sipas planit dinamik, si dhe aty ku është e nevojshme të zbatohen masat ndëshkuese sipas kushteve të përcaktuara në kontratë, në mënyrë që të rritet përgjegjësia tek operatorët ekonomik.

Çështja 9 - Kontraktim i punëve pa zotimin e plotë të mjeteve

E gjetura Sipas Rregullës Financiare 01/2013, asnjë kontratë nuk duhet të nënshkruhet pa zotimin paraprak dhe se zotimi duhet të jetë pjesë përbërëse e kontratës. Në kontratën “Rregullimi i rrjetit të kanalizimit fekal Gjilan – Veleknice” në vlerë 109,571€, zotimi i mjeteve ishte bërë vetëm për 20,000€, ndonëse kontrata ishte paraparë të përfundoj brenda vitit.

Rreziku Hyrja në obligime në mungesë të mjeteve, rrezikon mos përmbushjen e kontratës apo zbatimin e vonshëm të saj dhe në këtë mënyrë mosarritjen e objektivave të Komunës.

Rekomandimi 9 Kryetari, të sigurojë se asnjë kontratë nuk nënshkruhet pa siguruar fondet e mjaftueshme për realizimin e saj në periudha të parapara.

3.7 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 10 - Tejkalimi i vlerës/sasisë së kontraktuar

E gjetura	<p>Në tri kontrata ne identifikuar se pagesat kishin tejkaluar dukshëm çmimin e kontraktuar, si:</p> <ul style="list-style-type: none">• Në kontratën për “Mirëmbajtje të ndriçimit publik për fshatrat e Komunës së Gjilanit” në vlerë 166,674€, vlera e punëve të kryera sipas situacioneve të përfunduara ishte 267,583€, duke tejkaluar vlerën e kontratës për 100,909€, ose 61%. Nga raporti i menaxherit të projektit, nuk kishte ndonjë arsytim për tejkalimin e kontratës;• Vlera e kontratës “Hartimi i projekteve kryesore në komunën e Gjilanit llot-2” ishte 18,364€, ndërsa nga dy pagesa të testuara lidhur me këtë kontratë, shpenzimet ishin në vlerë 122,425€. Vlera e tejkaluar e kontratës ishte 104,061€, duke tejkaluar vlerën e kontratës afro gjashtë herë; dhe• Sipas kontratës “Furnizim me dru për ngrohje Lot 1” e nënshkruar me 20/09/2017, vlera e përgjithshme e furnizimit ishte 217,428€, ndërsa sasia 4,737m³. Deri në fund të vitit 2017, komuna ishte furnizuar me sasi prej 5,480m³, duke hyrë në obligime tej kontraktuale në vlerë 34,107€, obligime këto të cilat ishin bartur në vitin vijues. Kjo kishte ndodhur si pasojë e një mos planifikimi të mirë të nevojave nga njësia kërkuese.
Rreziku	<p>Tejkalimi i vlerave/sasive të kontraktuara, shpie në rrezikun e rritjes së obligimeve jashtë kontraktuale që mund të rezultojnë me pagesa të parregullta si dhe me ndëshkime të pagesave përmes vendimeve gjyqësore, duke rënduar kështu buxhetin e komunës dhe duke rrezikuar realizimin e projekteve tjera të planifikuara.</p>
Rekomandimi 10	<p>Kryetari të siguroj kontrollë shtese në menaxhimin e kontratave në mënyrë që punët/furnizimet bëhen në pajtim me sasi të/vlerën e kontraktuar dhe komuna nuk hyn në obligime përtej kontratës.</p>

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Komuna ka përfillur rekomandimin e dhënë lidhur me regjistrimin e pronave komunale, duke i regjistruar ato në regjistrin kontabël, megjithatë ende janë evidentuar mangësi në menaxhimin e pasurisë.

Çështja 11 - Klasifikimi joadekuat i pasurive

E gjetura Sipas rregullores mbi pasurinë jo financiare⁵, kostoja e mirëmbajtjes së pasurive kapitale nuk konsiderohet përmirësim dhe si e tillë nuk regjistrohet si shpenzim kapital. Blerjet në vlerë 177,066€, që kishin të bënin me mirëmbajtjen e ndriçimit publik si dhe sinjalizimin horizontal e vertikal, ishin regjistruar si pasuri, ndonëse sipas natyrës ato i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Kjo kishte ndodhur si pasojë e shpenzimit të këtyre mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale.

Pagesat në vlerë 39,473€ për “Projekte të vogla në infrastrukturë”, ishin regjistruar sipas emërimit të përgjithësuar të projektit dhe jo sipas vendndodhjes së tyre. Kjo pasi zyrtari i pasurisë i ka regjistruar ato në bazë të pagesave të cilat nuk përmbanin informacione lidhur me vendndodhjen e kryerjes së punimeve.

Rreziku Regjistrimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes si pasuri në regjistrat kontabël ndikon në mbivlerësimin e vlerës së pasurisë e shpalosur në PFV. Ndërsa, regjistrimi i pasurive pa qartësuar vendndodhjen e tyre, nuk e tregon saktë gjendjen e pasurive të komunës dhe pamundëson kontrollin efektiv mbi to.

Rekomandimi 11 Kryetari të siguroj se janë ndërmarrë veprimet për korrigjimin e regjistrit të pasurisë, me ç’rast blerjet që nuk rezultojnë në një pasuri ose përmirësim të pasurisë, nuk regjistrohen në regjistrin kontabël. Me tutje, regjistri i pasurisë duhet të posedojë të gjitha të dhënat përkatëse, përfshirë edhe lokacionin e tyre.

⁵ Rregullore nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore, neni 15

Çështja 12 - Mosfunksionimi i e-pasurisë dhe pranimit të mallit në mungesë të komisionit

E gjetura Sipas rregullores mbi pasurinë jo financiare⁶, pasuria nën 1,000€ dhe stoqet duhet të regjistrohen në sistemin E-pasuria. Ky sistem, në komune nuk përdoret nga zyrtarët përgjegjës. Pasuritë nën 1,000€, zyrtari i pasurisë i mban veçmas në formë të excel, me ç'rast i regjistron sipas datës së blerjes ndërsa nuk aplikon zhvlerësimin tek ato. Si pasojë shpалosja e pasurive nën 1,000€ në PFV ishte e mbivlerësuar.

Me tutje, me rastin e pranimit të mallit sipas pagesës në vlerë 4,622€, ndonëse ishte formuar komisioni prej tre anëtarësh për pranim të mallit, malli ishte pranuar vetëm nga një person.

Rreziku Dobësitë e identifikuara në pranimin dhe regjistrimin e pasurive jokapitale, shpijnë në menaxhim joefikas të këtyre pasurive, nënvlerësimin e tyre dhe në rrezikun e pranimit të mallit jo në përputhje me kushtet e kontraktuara.

Rekomandimi 12 Kryetari të sigurojë që janë marrë veprimet e nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që menaxhimi dhe raportimi i pasurisë të behët në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Me pas të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e komunës të cilët do të përcaktohen përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi. Gjithashtu, duhet të sigurojë që të gjitha mallrat dhe shërbimet pranohen përmes komisioneve të themeluara për pranimin e tyre.

3.9 Të arkëtueshmet

Në fund të vitit 2017, llogaritë e arkëtueshme (LL/A) ishin 9,595,680€ ku prej tyre pjesëmarrja ishte si në vijim: Licencat për biznes (veprimtaritë banesore) në vlerë: 1,720,800€; Qiraja në vlerë 348,130€; Tatimi në pronë në vlerë 7,424,900€; PPP (Partneriteti Publiko Privat) në vlerë 33,400€ dhe Inkubatori në vlerë 6,450€. Krahasuar me vitin 2016, LL/A, kishin pësuar rritje prej 2% apo në vlerë 149,580€.

LL/A nga tatimi në pronë krahasuar me vitin paraprak kishin pësuar rritje në vlerë 129,600€. Kjo për shkak të mungesës së vendosjes së mekanizmave nga komuna për rritjen e arkëtimin të këtyre të hyrave dhe mungesës së saktësisë së të dhënave rreth pronave të tatueshme.

Rekomandimet

Në nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

⁶ Rregullore nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore, neni 6

3.10 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve të prezantuar në PFV në fund të vitit 2017 ishte 2,453,971€. Obligimet e prezantuar janë bartur për t'u paguar në vitin vijues.

Çështjet lidhur me obligimet ne i kemi trajtuar tek Kapitulli i Opinionit të Auditimit - baza për opinion, andaj ne nuk kemi ndonjë çështje tjetër për ta theksuar në këtë pjesë.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime tjera në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të komunës së Gjilanit ka rezultuar në 18 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Komuna në bashkëpunim me USAID kishte organizuar një punëtori ku kishin marrë pjesë personat përgjegjës me ç'rast ishte diskutuar lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve dhe nga këtu ishte prodhuar një raport ku ju është dhënë prioritet çështjeve kryesore me ndikim në opinion të auditimit, për tu zbatuar në afat të menjëhershëm. Megjithatë, nga shqyrtimi i proces-verbaleve të Kuvendit Komunal, nuk kemi hasur në raste kur është diskutuar lidhur me gjetjet, rekomandimet e auditimit, si dhe planin e veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë, nga 18 rekomandimet e dhëna për vitin 2016, gjashtë rekomandime janë zbatuar; 10 ishin në proces, ndërsa dy nuk ishin zbatuar. Po ashtu, nga viti 2015 nga 13 rekomandime të bartura, tri nuk janë zbatuar dhe 10 tjera ishin në proces të zbatimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II

Çështja 13 - Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga vitet paraprake

E gjetura Mungesa e një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, ka ndikuar që një numër i vogël i rekomandimeve të janë zbatuar plotësisht, ndërsa pjesa më e madhe e tyre janë në proces të zbatimit, përfshirë këtu edhe rekomandimet nga vitet paraprake. Kjo tregon një mungesë të përqendrimit të personave përgjegjës në aplikimin e masave konkrete lidhur me adresimin e këtyre rekomandimeve, që vijnë si rezultat i dobësive të identifikuara në komunë.

Moszbatimi i rekomandimeve në vazhdimësi, tregon se kontrollet e menaxhmentit dhe sistemeve tjera financiare nuk kanë funksionuar mjaftueshëm dhe kjo ka rezultuar në:

- Dobësi në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve;
- Menaxhimi jo i mirë i kontratave në fushën e prokurimit (vonesat, tejkalimet e kontratave);
- Keq klasifikim i shpenzimeve dhe regjistrimi i pasaktë i pasurive në regjistrin kontabël; dhe
- Mbikëqyrje jo e mjaftueshme në ndarjen e subvencioneve dhe raportimin e tyre.

Rreziku Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, vështirësi në menaxhimin e sfidave në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të sigurojë që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk zbatohen sipas afateve, të rishikohen në një afat të shkurtër nga kryetari, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Në qeverisjen lidhur me aktivitetet operacionale dhe financiare në komunë ende mbesin fusha ku nevojiten veprime të rëndësishme. Përgjigjet efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve të auditimit të jashtëm, zhvillimi mbi proceset e menaxhimit të rrezikut, menaxhimi i obligimeve të papaguara, si dhe zbatimi i rekomandimeve të auditimit të brendshëm janë disa nga fushat të cilat komuna duhet dhënë prioritet sa i përket një qeverisjeje më efektive.

Si pjesë të planeve strategjike, komuna ka hartuar Strategjinë për Zhvillim Socio-ekonomik 2017-2021, ndërsa është në proces të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal. Në planin strategjik të saj, komuna ka identifikuar objektivat e saj lidhur me realizimin e projekteve kapitale gjatë katër viteve të ardhshme. Katër nga këto projekte të planifikuara të fillohen gjatë vitit 2017 nuk kishin arritur të inicohen për shkak të dështimit të procedurave të prokurimit.

Komuna këtë vit ka shënuar një progres duke përpiluar listën e rreziqeve në të cilën janë identifikuar pika të rëndësishme të rreziqeve me të cilat përballen departamentet përkatëse. Megjithëse, në këtë listë nuk janë përfshirë paditë që i bëhen komunës si detyrime kontingjente të shkallës së dytë, që do të thotë me mundësi më të lartë të ndodhjes. Gjithashtu mungonte një plan përmes të cilit identifikohen masat parandaluese, mënyrat e reagimit ndaj këtyre rreziqeve, identifikimi i personave kyç, të ashtuquajtur pronar të këtyre rreziqeve, si dhe vendosja e mekanizmave për kërkesa të raportimit nga këta persona për çështjet e identifikuar me rrezik.

Një ndër elementet kyçe të një qeverisjeje efektive është edhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i jashtëm. Përgjigja efektive ndaj zbatimit të rekomandimeve nuk është e kënaqshme. Kjo pjesë është trajtuar më detajisht tek kapitulli 'Progresi i zbatimit të rekomandimeve'.

Komiteti i Auditimit (KA) ka qenë funksional dhe ka mbajtur takime, ku është bërë shqyrtimi i rekomandimeve të dhëna nga Auditori i Brendshëm (AB) dhe niveli i zbatimit të tyre. Pavarësisht kësaj, adresimi i rekomandimeve nga auditori i brendshëm ende mbetet i ulët.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit - drejtori i NjAB dhe dy auditorë. NjAB kishte hartuar planin strategjik dhe planin vjetor të punës, ku ishin përfshirë disa fusha rishikimi për vitin 2017. NjAB kishte përfunduar të gjitha auditimet e planifikuara, që gjithsej përbënin 12 sosh. Ne kemi marrë në konsideratë punën e auditorëve të brendshëm, veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë në adresimin e rekomandimeve si dhe angazhimet KA-së. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Çështja 14 - Niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga menaxhmenti i komunës

E gjetura Nga 31 rekomandime të dhëna, 13 ishin zbatuar që reflekton një numër të vogël të zbatimit të tyre. Menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprime të mjaftueshme dhe efektive për t'i evituar mangësitë e identifikuara nga auditimi i brendshëm dhe për të marrë përfitimet në lidhje me forcimin e funksionimit të kontrolleve të brendshme.

Rreziku Mos zbatimi i rekomandimeve do të ndikojë drejtpërdrejtë në efektivitetin dhe efikasitetin e kontrolleve të brendshme në komunë dhe përsëritjen e dobësive të identifikuara.

Rekomandimi 14 Kryetari të siguroj se ka rritë bashkëpunimin me NjAB dhe KA, si dhe të merr masa në ngritjen e gatishmërisë së menaxhmentit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së, për një funksionim më efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara nuk janë mjaft efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 15 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura

Si pasojë e mosfunksionimit të duhur të kontrolleve menaxheriale, menaxhimi jo i mirë i pranimit dhe përcjelljes së faturave, ka ndikuar që obligimet të mos shpalosen në vlerën e saktë në PFV. Dobësi menaxheriale janë vërejtur në fushën e prokurimit, ku menaxhimi i projekteve kapitale ka pasur ngecje që kanë rezultuar me vonesa të projekteve, kontrata të përgjithësuara pa identifikuar projektet e synuara për investim, tejkalime të çmimit/sasive të kontratës. Si rezultat i hyrjes në obligime pa mjete të zotuar, kishin ndodhur pagesa përmes vendimeve me përmbarues. Llogaritë e arkëtueshme kishin pësuar rritje megjithatë nuk ishin ndërmarrë masa specifike për arkëtimin e tyre. Numri i pronave komunale për efekt të tatimit në pronë nuk ishte verifikuar plotësisht, gjithashtu objektet e dhëna me qira vazhdonin të shfrytëzoheshin në mospajtim me ligjin. Pasuria në anën tjetër, vazhdonte të mos pasqyronte gjendjen e saktë si rezultat i regjistrimit të mallrave/shërbimeve si pasuri kapitale, ndërsa e-pasuria vazhdonte të mos funksiononte.

Komuna gjithashtu nuk ka politika të shkruara dhe procedura për menaxhimin e rreziqeve, në veçanti rrezikut të mashtrimit dhe parregullsive. Regjistri i rreziqeve i hartuar sipas kërkesave të MFK-së, nuk përmban një strategji për menaxhimin e tyre.

Rreziku

Kërkesat e pamjaftueshme të llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë jo të mirë reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar. Kjo rezulton me dobësi në procesin e buxhetit dhe e zvogëlon aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 15

Kryetari duhet të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë. Ecuritë buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, dhe plani i prokurimit duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, komuna duhet të pasuroj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Adresimi i rekomandimeve nga viti i kaluar	Kryetari duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Nuk ka zbatim të plotë të rekomandimeve të vitit 2015, ende ka çështje që janë përsëritur gjatë vitit 2017.	
Qeverisja e mirë	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.		Pyetëtori i vetëvlerësimit është plotësuar megjithatë mungon dokumentacioni i mjaftueshëm që e mbështet saktësinë e përgjigjeve të dhëna.	
Vlerësimi i rrezikut	Kryetari duhet sa më parë të miratoj një strategji të përgjithshme të menaxhimit të rrezikut, ku do të përcaktohet qartë qasja e menaxhmentit për reagime ndaj rreziqeve. Krahas identifikimit të rreziqeve në nivel operativ dhe strategjik, menaxhmenti duhet të hartoj edhe një plan veprimi ku përcaktohen masat e veprimit për të parandaluar dhe menaxhuar rreziqet e mundshme.		Është përgatitur lista e rreziqeve megjithatë mungon një plan veprimi për përcaktimin e masave të veprimit ndaj rreziqeve të identifikuara	

Raportimi Menaxherial	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri në fund të vitit 2016.		Drejtoria e financave raporton rregullisht mbi te hyrat dhe shpenzimet tek menaxhmenti i larte, megjithatë nuk ka raportime formale nga të gjitha drejtoritë në baza të rregullta kohore.	
Plani Zhvillimor i Komunës	Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbej si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.		Komuna ka hartuar strategjinë për zhvillim socio-ekonomik 2017-2021, ku janë paraparë projektet kapitale për tu realizuar gjatë këtyre viteve, megjithatë plani zhvillimor komunal dhe harta zonale ende është në proces të hartimit.	
Sistemi i audiitimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga shërbimet e auditimit të brendshëm, Kryetari i Komunës duhet të rishikojë arsyet për veprimet e limituara, të ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e audiitimit të brendshëm dhe të bashkëpunoj me Komitetin e audiitimit për ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm		Zbatimi i rekomandimeve të AB ende nuk është në nivel të kënaqshëm.	
Prokurimi	Kryetari duhet të siguroj një rishikim të rasteve të identifikuar për të gjetur shkaqet e ndodhjes dhe të marrë masat e duhura për evitimin e tyre në te ardhmen. Veçanërisht duhet të rris llogaridhënien e personave përgjegjës qoftë të njësisë kërkuese, zyrtarëve të prokurimit dhe menaxherëve të kontratave. Rrjedhimisht, duhet të vendosen kontrole të shtuara për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuar janë adresuar.		Ende ka mungesë të kontroleve në fushën e prokurimit, duke filluar nga mangësitë tek njësia kërkuese e deri të menaxhimi i kontratave.	

Prokurimi	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim për të përcaktuar pse në rastet e mësipërme kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Rrjedhimisht, duhen kontrole të shtuara për të siguruar që një situatë e ngjashme nuk do të përsëritet në prokurimet e ardhshme dhe që të gjitha shpenzimet bëhen sipas kodeve përkatëse në përputhje me kërkesat e LMFP-së dhe Ligjit të Buxhetit.		Në disa raste ende janë prezentë mangësitë e identifikuar si: planifikimi/shpenzimi nga kategoritë joadekuate, vonesat në ekzekutim dhe skadimi i sigurisë së ekzekutimit.	
Subvencionet dhe Transferet	Kryetari duhet të rishikojë rastet e identifikuar për të siguruar që kontrollet në këtë fushë janë aplikuar sipas parashikimeve dhe për të siguruar që mjetet janë përdorur për qëllimin e planifikuar dhe në pajtim me rregulloret.		Përkundër përmirësimeve në raport me vitet paraprake, ende ka mangësi në respektimin e rregullores sa i përket ndarjes së subvencioneve.	
Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)	Kryetari të siguroj që fazën e planifikimit të buxhetit vjetor të shfrytëzoj të dhënat e viteve të kaluara dhe gjendjen aktuale që planifikimi të jetë sa më real. Përveç kësaj, duhet të monitoroj kontrollet aktuale të aplikuar në realizimin e të hyrave si dhe të sigurojë procedurat e nevojshme për dhënien në shfrytëzim të pasurive komunale, në mënyrë që të sigurohet transparencë, dhe të bëhet trajtimi i drejtë dhe i barabartë për të gjithë shfrytëzuesit gjatë dhënies në shfrytëzim të objekteve me qira.		Është organizuar një ankand por ka të bëjë me lëshimin e objekteve tjera afariste me qira, ndërsa për kontratat që ne kemi dhënë rekomandim ende nuk janë vënë në ankand publik.	
Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të rishikojë pse pasuritë e identifikuar nuk janë regjistruar në sistemin E-pasuria, dhe të adresojë dobësitë që kanë të bëjnë me azhurnimin e vazhdueshëm të regjistrimit të pasurisë. Kërkesat në lidhje me regjistrimin dhe mirëmbajtjen e tyre duhet të aplikohen në tërësi.			Nuk janë marrë masa.

Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari duhet ta shqyrtoj gjendjen e këtyre llogarive, të analizoj arsyet për akumulimin e këtyre shumave të konsiderueshme dhe të ndërmer veprime efektive për maksimizimin e shkallës së inkasimit. Procesi i monitorimit sistematik të masave dhe politikave për rritjen e inkasimeve, duhet të jetë gjithashtu pjesë e shqyrtimeve të rregullta të menaxhmentit.			Nuk janë marrë masa.
Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të shqyrtoj në mënyrë kritike gjendjen e detyrimeve të papaguara, për të përcaktuar masat e nevojshme për adresimin e çështjeve të identifikuar, dhe pagesat të bëhen në kuadër të limiteve kohore të përcaktuara me rregullat financiare. Për trajtimin e detyrimeve kontingente në koordinim me Përfaqësuesin Ligjor të komunës, duhet të ndërmer një rishikim të gjendjes së detyrimeve, për të përcaktuar prioritetin e pagesave, duke iu shmangur ekzekutimeve direkte nga MF.			Nuk janë marrë masa.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2. Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes së Opinionit. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike për t'i evituar gabimet në keq klasifikimin e shpenzimeve dhe mos regjistrimin e saktë të pasurive. Gjithashtu, duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport dhe Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Po		

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryetari duhet të aplikoj masa përgjegjësie ndaj personave të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve dhe sigurojë se plani i veprimit po zbatohet me kohë dhe në mënyrë efektive për të gjitha rekomandimet e dhëna, dhe me fokus të veçantë tek ato me prioritet të lartë. Progresi në zbatimin e rekomandimeve duhet t'i nënshtrohet rishikimeve sistematike nga Kryetari.		Është mbajtur një punëtori ku është diskutuar mes disa përfaqësuesve të drejtorive rreth zbatimit të rekomandimeve por nuk ka dëshmi të takimeve të mbajtura të Kryetarit me drejtoritë përkatëse.	
2.2 Pyetësi i vetvlerësimit	Kryetari duhet të sigurojë se është rishikuar plotësisht i listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë proaktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës. Ne sugjerojmë që rishikimi final i pyetësit të vetvlerësimit të kryhet nga auditimi i brendshëm.		Pyetësi i vetvlerësimit është plotësuar megjithatë në disa pohime të dhëna mungon dokumentacioni i mjaftueshëm për të dëshmuar plotësisht e tyre.	
2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes	Kryetari duhet të miratojë një plan të përgjithshëm strategjik për komunën i cili do të përcaktojë objektivat afatgjata dhe të shërbejë si platformë orientuese për hartimin e planeve vjetore, kryerjen e analizave krahasuese mes viteve dhe matjen e rezultateve kundrejt objektivave.		Komuna ka hartuar Strategjinë për zhvillim socio-ekonomik 2017-2021, megjithatë ende nuk ka hartuar Planin Zhvillimor Komunal dhe hartën zonale siç kërkohet me ligj.	
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.		Drejtoria e financave raporton rregullisht mbi të hyrat dhe shpenzimet tek menaxhmenti i lartë, megjithatë nuk ka raportime formale nga të gjitha drejtoritë mbi aktivitetet financiare dhe operative në baza të rregullta kohore.	

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti auditimit të brendshëm, Kryetari duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.		Kryetari së bashku me Këshillin e drejtorëve së paku tri here e kanë diskutuar çështjen e rritjes së shkallës së zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna nga auditori i brendshëm (ftesat për takim dhe rendi i ditës), mirëpo nuk ka procesverbale nga këto takime.	
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson shkaqet për mos implementim me kohë të investimeve kapitale dhe për bartjen e vazhdueshme të obligimeve në buxhetet e viteve vijuese. Aty ku projektimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, duhet të reflektohen plotësisht në pozitën e buxhetit final.	Po		
Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që të bëhet verifikimi i 1/3 të pronave për tatimin në pronë në pajtim me kërkesat e UA 03/2011 dhe të sigurojë që zyrtari i tatimit në pronë bën kërkesa në institucionin përkatës që sistemi protax të gjenerojë me kohë raportet për të hyrat e tatimit në pronë dhe të njëjtat të jenë në përputhshmëri me raportet e thesarit.		Nuk ka arritur të bëhet verifikimi i 1/3 të pronave për shkak të mungesës së stafit të angazhuar.	
Të hyrat nga qiraja	Rekomandohet Kryetari që të iniciojë procedurat për organizimin e ankandit publik në mënyrë që të aplikohen parimet ligjore në fuqi dhe njëkohësisht të sigurohet transparencë dhe trajtim i drejtë dhe i barabartë për të gjithë shfrytëzuesit e mundshëm gjatë dhënies së objekteve me qira.		Është organizuar një ankand por ka të bëjë me lëshimin e objekteve tjera afariste me qira, ndërsa për kontratat që ne kemi dhënë rekomandim ende nuk janë vënë në ankand publik.	

Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të angazhoj stafin që të bëj unifikimin e kontratave për stafin arsimor dhe kontratat të përfshijnë të gjitha informacionet e nevojshme në pajtueshmëri me rregulloret në fuqi.	Po		
Mallrat dhe shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë se punonjësit e angazhuar përmes marrëveshjeve për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike, dhe mbajtja e tatimeve në burim të jetë në harmoni me legjislacionin e aplikueshëm në fuqi.	Po		
Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që gjatë aplikimit për subvencione, zbatohen të gjitha kërkesat specifike të rregullore dhe bashkë me aplikacionet dorëzohen edhe projektet e kërkuara.		Ende ka mangësi në respektimin e rregullores sa i përket ndarjes së subvencioneve	
Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se para se të fillohet me procedura për ndarjen e subvencioneve për vlera të tilla, të merret vendimi nga Kuvendi Komunal ose këto projekte të përfshihen paraprakisht gjatë aprovimit të buxhetit vjetor.	Po		
Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se realizimi i projekteve bëhet sipas kushteve dhe afateve të parapara, duke siguruar që me kohë të merren përfitimet e parapara nga projektet e tilla, të sigurohet vlera për paranë e shpenzuar dhe mos të ketë bartje të obligimeve për vite me radhë.			Nuk janë marrë masa.
3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që do të ndërmerr një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kërkesat e prokurimit nuk janë adresuar në të gjitha rastet e prokurimit, dhe të ushtrojë më shumë kontrolle për të siguruar se dobësitë e identifikuara do të evitohen në të ardhmen.		Disa nga mangësitë e evidentuara janë përsëritur.	

3.2 Pasuritë	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që me rastin e regjistrimit të pasurisë në libra kontabël, pasuritë kapitale dhe jo kapitale të regjistrohen me të gjitha të dhënat e përcaktuara me kërkesat e Rregullores për Menaxhimin e Pasurive nr.02/2013, duke përfshirë edhe lokacionin.		Ka përmirësime por ende ka regjistrime në mungesë të të dhënave të plota.	
Të arkëtueshmet	Kryetari duhet të sigurojë se bëhet një kontroll dhe vlerësim detal dhe i saktë i LL/A. Në mënyrë raportet të jenë të besueshme dhe të sakta, duhet të shtohet bashkëpunimi me departamentin e tatimit në pronë në kuadër të MF.	Po		
3.3 Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se do të rishikohet procesi i pranimit dhe përcjelljes së faturave për pagesë në mënyrë që të mundësojë menaxhim të drejtë, me kohë dhe të mbështesë raportimin e plotë të obligimeve të papaguara. Po ashtu, të sigurojë se obligimet e pranuar janë të mbështetura me fatura apo dëshmi tjera të nevojshme.			Nuk janë marrë masa.

Shtojca III: Letër Konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPAL GJILAN / GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, kk.gjilani-komuna.org, e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjilanit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimtimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. **Lutfi Haziri**
Kryetar i Komunës,
Data: 08.06.2018, Gjilan,

